



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 17, datë 31.01.2023

**PËR
MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VKB NR. 139, DATË 24.11.2022 “PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS
PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2023”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar ; neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma “b”, të nenit 51, pika 3, nenit 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimaterike”, VKM nr.466, datë 3.07.2019, “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”; Strategjisë Kombëtare e Rinisë 2022-2029 dhe Planit të Veprimit; Rregullores së Funksionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, Kreu VIII. “Financimi i Aktiviteteve të Këshillit”, Neni 101 “Programi i Punës së Këshillit Bashkiak” dhe sipas relacionit të hartuar nga 5 (pesë) anëtarë të Këshillit Bashkiak, miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, me propozim të 5 (pesë) anëtarë të Këshillit Bashkiak,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e disa shtesave në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 139, datë 24.11.2022 “Për miratimin e programit të punës së këshillit të bashkisë Durrës për periudhën janar – dhjetor 2023”, duke shtuar pikat si më poshtë:

- a. Për muajin Mars 2023, të zhvillohet seancë informuese mbi ndryshimet klimaterike dhe situatat mjedisore në territorin e bashkisë Durrës.
 - b. Për muajin Prill 2023, të zhvillohet fushatë ndërgjegjësuese e Këshillit Bashkiak në bashkëpunim me Këshillin Rinor Vendor, për rritjen dhe ndërgjegjësimin e të rinjve si edhe për dhënien e kontributit në përmirësimin e jetës në komunitet dhe aktivitete të tjera.
2. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Këshilli Bashkiak Durrës dhe Kryetari i Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.02.2023



09/02/23 273/5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 85 / prot.

5

Durrës, më 09 . 02 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.17 datë 31.01.2023 “Për miratimin e disa shtesave në VKB nr 139 dt 24.11.2022 “Për miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Durrës për periudhën Janar- Dhjetor 2023”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

